

Në bazë të nenit 23 të Vendimit për themelimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar Transmetuesi lokal publik „Radio Televizioni i Ulqinit“ („Fl. Zyr. MZ – dispozitat e komunës“, nr. 38/11) dhe nenit 58, paragrafi 1, pika 22 të Statutit të Komunës së Ulqinit („Fl. Zyr. MZ – dispozitat e komunës“, nr. 48/19), Kuvendi i Komunës së Ulqinit në mbledhjen e mbajtur, më ____ . ____ . 2020 ka nxjerrë

**AKTVENDIMIN
PËR EMËRIMIN E ANËTARIT TË KËSHILLIT TË
TRANSMETUESIT LOKAL PUBLIK „RADIO TELEVISIONI – ULQIN“**

I. Dragomir Rakočević kandidat i shoqërive ekonomike dhe sipërmarrësve nga Ulqini, emërohet anëtar i Këshillit të transmetuesit lokal publik „ Radio Televizioni – Ulqin,,

II. Ky Aktvendim hynë në fuqi ditën e nxjerrjes dhe do të publikohet në „Fletoren zyrtare të Malit të Zi – dispozitat e komunës“.

KUVENDI I KOMUNËS SË ULQINIT

Numër: 02 -
Ulqin, më ____ . ____ . 2020

Kryetari
Dr. Ilir Çapuni

Arsyetim

Neni 23 dhe 24 i Vendimit për themelimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar Transmetuesi lokal publik „Radio Televizioni i Ulqinit“ („Fl. Zyr. MZ – dispozitat e komunës“, nr. 38/11) përcakton detyrimin për emërimin e anëtarit të Këshillit të transmetuesit lokal publik nga ana e Kuvendit të Komunës së Ulqinit.

Kryetarja e Këshillit RTUL me aktin përcjellës nr. 164/9-2 të dates 11.12.2019 e ka lajmëruar Kryetarin e Kuvendit që është e nevojshme të bëhet thirja publike për emërimin e anëtarit të Këshillit nga fusha e shoqërive ekonomike dhe sipërmarrësve.

Këshilli për zgjedhje dhe emërimë më datë 21.02.2020 e ka shpallur thirrjen publike për të pestën here në mjetet e informimit publik. Në thirrjen publike janë paraqitur dy kandidat.

Këshilli për zgjedhje dhe emërimë në mbledhjen e mbajtur më datë 08.05.2020 pasi ka shqyrtuar dokumentacioni e ka vërtetuar që kandidati i propozuar, në terësi i plotëson kushtet për anëtar të Këshillit kurse kandidati i dytë nuk i plotëson kushtet e nevojshme të parapara më Ligj.

Duke marrë parasysh atë çka është cekur më lartë Këshilli i propozon Kuvendit Aktvendimin si në dispozitiv.

Këshilli për zgjedhje dhe emërimë